



**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe
audiovizuele**

**Plani është pjesë e PROGRAMIT TË
ZGJERUAR PËR PROMOVIMIN E ARSIMIMIT MEDIATIK**

Hyrje

E drejta për përgjigje dhe korrigjim është një prej mënyrave se si qytetarët dhe subjektet e tjera të interesuara, mund që duke apeluar lidhur me obligimet që redaksitë të respektojnë standardet dhe parimet e gazetarisë si profesion, që ta mbrojnë dinjitetin e tyre ose të ndihmojnë për të qartësuar ndonjë dezinformatë.

Ajo është një mekanizëm përmes të cilit qytetarët dhe subjektet juridike mund ti thirrin për përgjegjësi mediumet në rastet kur ata, rastësisht ose me qëllim, do të publikojnë ndonjë informatë të pasaktë ose do të shkelin të drejtat dhe interesat e dikujt.

Përvoja dhe praktika e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dëshmon se kjo praktikë, fatkeqësisht përdoret rrallëherë. Kjo, nga njëra anë, mund të nënkuptojë se qytetarët dhe personat juridik nuk janë mjaft të informuar për mënyrat se si kërkohet publikimi i përgjigjes ose korrigjimit, ndërsa në anën tjetër dëshmon edhe për mos përgatitjen e medimeve që ta plotësojnë këtë obligim të tyre jo vetëm profesional por edhe të përcaktuar me ligj. Në këtë drejtim, e drejta për përgjigje dhe korrigjim theksohet në nenin 14 të Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe ofendim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 143/12), ndërsa detalisht e përpunuar në nenet nga

15 deri në 26 të Ligjit për mediumet ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13 dhe 13/14).

Përdorimi i rrallë i këtij mjeti juridik, me legjitimitet e hap dilemën nëse do të vinte deri te rastet gjyqësore për shpifje ose ofendim nëse do të kërkohet ose publikohet përgjigje ose korrigjim. Dilema e këtillë përputhet edhe me disa prej potencimeve dhe propozimeve nga misioni i ekspertëve, kushtuar shpifjes dhe ofendimit në Republikën e Maqedonisë, të realizuar në periudhën nga 13 deri në 14 tetor të vitit 2014, përmes bashkëpunimit të institucioneve të Maqedonisë me Këshillin e Evropës.

Nga ai bashkëpunim dolën disa potencime që kanë të bëjnë me të drejtën e përgjigjes dhe korrigjimit. Për shembull, propozohet që të shqyrtohet mundësia që gjykatësit të vlerësojnë nëse është më adekuate që ndonjë lëndë për ofendim dhe shpifje të dërgohet për zgjidhje jashtëgjyqësore, në vend që të shpenzohen mjetet dhe resurset e gjykatës, si dhe të punohet për ngritjen e vetëdijes te qytetarët dhe subjektet e tjera se nuk duhet që për çdo rast të fillojnë procedurë gjyqësore e cila më pas do të hidhet poshtë, sepse iniciimi i mekanizmit gjyqësor tërheq shpenzime të mëdha financiare. Në këtë kontekst, inkurajohen që më shumë të përdoret përgjigja dhe korrigjimi, pikërisht me qëllim që të ulen procedurat gjyqësore për shpifje dhe ofendim, me ç'rast paraqiten propozime – Agjencia të ofrojë ndihmë profesionale në formë të udhëzimeve dhe potencimeve, ndërsa shoqatat e gazetarëve të paraqiten në rolin e lehtësuesve. në mesin e subjekteve dhe medimeve të interesuara. Përveç kësaj, hapet edhe çështja nëse Agjencia mund të zhvilloi një Kod me standarde minimale për informatat që i publikojnë mediumet.

Edhe pse Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nuk është kompetente për zbatimin e Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe ofendim, mbikëqyrjen që e realizon në pajtim me dispozitat e Ligjit për medime është e kufizuar (neni 27), çështja për popullarizimin e së drejtës për përgjigje dhe korrigjim ka pika të përbashkëta me punën e trupit rregullues. Në këtë aspekt, kompetencat themelore të Agjencisë janë: mbrojtja e interesave të qytetarëve në sferën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, dhe promovimi i arsimimit mediatik (neni 6 paragrafi 1 alinetë 7 dhe 12 të Ligjit

për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 и 132/14).

Në këtë kontest, në suaza të përgatitjes së programit më të gjërë për promovimin e arsimimit mediatik, Agjencia e përpiloi këtë Plan për popullarizimin e së drejtës për korrigjim dhe përgjigje, me ç'rast, me aktivitetet e planifikuara nuk del jashtë kompetencave të saja si trup rregullues.

Grupet e qëllimit janë qytetarët dhe subjektet juridike, si dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale. Në aspekt të grupit të parë, qëllimi i masave të planifikuara është që të ngritet vetëdija te qytetarët dhe subjektet juridike për mundësinë për të korrigjuar informatë të pasaktë, si dhe të mbrojnë nderin dhe dinjitetin e tyre, duke përdorur mekanizmin që ju ofron Ligji për mediumet. Në aspekt të grupit të dytë, qëllimi është që ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, më mirë të njihen me obligimet dhe të drejtat e tyre gjatë publikimit të përgjigjes ose korrigjimit.

Edhe pse gjatë misionit të ekspertëve është sugjeruar miratimi i Kodit me standardet minimale për informatat që i publikojnë mediumet, Plani atë nuk e parasheh sepse një dokument i tillë duhet dhe mund të jetë akt vetërregullues, respektivisht nuk mund të dalë nga trupi rregullues. Gjithsesi, radiodifuzerët, gazetarët dhe shoqatat e tyre do të informohen se ekziston një mundësi e atillë dhe nëse vendosin që të krijojnë dhe miratojnë një akt të tillë, Agjencia do ti përkrah.

Aktivitetet për popullarizimin e së drejtës për përgjigje dhe korrigjim

1. **"PËRGJIGJA DHE KORRIGJIMI – KUSH, KUR DHE SI?"** Zhvillimi i pjesës së veçantë të ueb faqes së Agjencisë përmes së cilës qytetarët dhe personat juridik do të mund të informohen për mundësitë ligjore dhe rregullat gjatë shfrytëzimit të së drejtës për përgjigje dhe korrigjim në atë mënyrë që në gjuhë popullore do të shpjegohen dispozitat ligjore të Ligjit për mediumet (Shtojca 1). Kjo pjesë e ueb faqes do të jetë në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.
2. **"Si deri te përgjigja dhe korrigjimi?"** Publikimi i lajmërimit/shpallje të paguar në së paku dy gazeta ditore, njëra në gjuhën maqedonase dhe njëra në gjuhën shqipe, e me të cilën do të tërhiqet vëmendja e qytetarëve ndaj informatave që gjenden në ueb faqen e Agjencisë.
3. **"Publikimi i përgjigjes dhe korrigjimit– roli i medimeve"** – Agjencia ka obligim që së paku një herë në çdo tre muaj të organizojë takime publike me palët e interesuara ku ata do të shprehin mendimet dhe qëndrimet për zhvillimin e shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (neni 9 nga Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale). Në njërin prej këtyre takimeve do të ketë seancë në të cilën publikuesit e medimeve do të informohen për atë se si të plotësojnë dispozitat ligjore për të drejtën e përgjigjes dhe korrigjimit. Në takim do të ftohen përfaqësues të medimeve, shoqatave qytetare dhe faktorë tjerë relevant.
4. **"bashkëpunimi i vazhdueshëm"** 3- Për rastet konkrete në lidhje me të drejtën e përgjigjes dhe korrigjimit, Agjencia mund të bashkëpunojë me shoqatat e gazetarëve, trupat vetërregullues për etikë në medime dhe me trupa tjerë.

Ekstrakt nga dispozitat për të drejtën e përgjegjes dhe korrigjimit, nga Ligji për medime ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/2013 dhe 13/2014) të cilat në gjuhë të popullarizuar do të sqarohen në pjesën e ueb faqes së Agjencisë, të titulluar "PERGJIGJA DHE KORRIGJIMI – KUSH, KUR DHE SI?"

E drejta e korrigjimit të informatës së publikuar

Neni 15

- (1) Secili ka të drejtë që nga një publikues i mediumit, respektivisht redaktor përgjegjës të kërkojë, që pa kompensim të publikojë korrigjim të informatës së publikuar në të cilën theksohen faktet e pasakta të publikuara në informatën, e me të cilën janë shkelur të drejtat ose interesat e tij. Të drejtë korrigjimi kanë edhe personat juridik si dhe organizata dhe trupa tjerë, nëse me informatën janë shkelur interesat dhe të drejtat e tyre.
- (2) Kërkesa për publikimin e korrigjimit parashtrohet deri te redaktori përgjegjës i publikuesit të mediumit në formë të shkruar në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të informatës për të cilën parashtrohet korrigjimi. Kërkesa patjetër duhet të arsyetohet dhe të nënshkruhet nga ana e parashtruesit të korrigjimit dhe ti përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme për parashtruesin e korrigjimit, si dhe adresën e tij.
- (3) Në korrigjimin e një informate të publikuar, krahas korrigjimit të konstatimeve të gabuara ose të pasakta, mund të jepen edhe fakte dhe rrethana me të cilat parashtruesi i korrigjimit i hedh poshtë ose dukshëm i ndryshon konstatimet e informatës së publikuar.
- (4) Në rast kur bëhet fjalë për kritikë shkencore ose artistike nuk jepet e drejta e korrigjimit, përveç nëse me të njëjtën bëhet vetëm korrigjimi i fakteve të pasakta.
- (5) Nuk mund të kërkohej korrigjim nëse publikuesi i mediumit, deri në ditën e parashtrimit të kërkesës për korrigjim, ka publikuar paraprakisht korrigjim të informatës së njëjtë. Nëse parashtruesi i kërkesës për korrigjim konsideron se publikuesi i mediumit nuk e ka publikuar korrigjimin në mënyrë adekuate, në atë rast mund të kërkojë realizimin e të drejtës së tij në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.
- (6) Nëse personi për të cilin ka të bëjë informata ka vdekur, të drejtë për publikimin e korrigjimit kanë fëmijët e tij, fëmijët e birësuar, bashkëshorti/ja, prindërit, kujdestarët, vëllezërit dhe motrat ose persona juridik, nëse informata ka të bëjë me veprimtarinë që e ka kryer personi i vdekur në lidhje me atë person juridik.
- (7) Parashtruesi i kërkesës për publikimin e korrigjimit duhet patjetër qartë ta theksojë informatën, respektivisht të dhënat e informatës për të cilat ka të bëjë kërkesa për korrigjim dhe data e publikimit të saj.

Publikimi i korrigjimit

Neni 16

(1) Korrigjimi publikohet, pa ndryshime dhe plotësime, në vendin e njëjtë ose adekuat të përmbajtjes së mediumit në mënyrë të njëjtë ose adekuate të asaj me të cilën ka qenë e publikuar informata. Korrigjimi nuk guxon që të jetë proporcionalisht më i gjatë se informata, respektivisht nga pjesa e informatës në fjalë. Korrigjimi mund të publikohet në formë të ndryshuar vetëm nëse për atë pajtohet parashtuesi i kërkesës së korrigjimit. Korrigjimi patjetër duhet të publikohet në mënyrë që nga vetë titulli të mund të shihet se bëhet fjalë për korrigjim. Korrigjim pa pëlqim të parashtuesit të kërkesës për korrigjimit nuk guxon që të publikohet në mes të reaksioneve ose letrave të lexuesve, respektivisht të shikuesve ose dëgjuesve.

(2) Në programet e radiodifuzerëve, korrigjimi publikohet me lexim në të njëjtin program ose termin kur është publikuar informata me të cilën ka të bëjë korrigjimi ose në të njëjtin lloj të programit me të njëjtin nivel të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë.

Mënyra dhe kushtet për publikimin e korrigjimit

Neni 17

(1) Korrigjimi patjetër duhet të publikohet në afat prej dy ditëve nga dorëzimi i kërkesës në numrin e parë të radhës, nëse bëhet fjalë për botime periodike në një medium tjetër, nëse bëhet fjalë për publikim jo periodik. Në një kohë të procesit zgjedhor, korrigjimi duhet patjetër të publikohet në edicionin e parë të radhës, respektivisht në programin e parë të radhës, të llojit të njëjtë, menjëherë pas pranimit të korrigjimit.

(2) Në edicionin e njëjtë, respektivisht programin e llojit të njëjtë, nuk mund që së bashku me korrigjimin të publikohet edhe koment të atij korrigjimi ose përgjigje të korrigjimit. Për koment ose përgjigje ndaj korrigjimit zbatohen dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me procedurën për realizimin e të drejtës së korrigjimit.

(3) Redaktori përgjegjës është i obliguar që ta publikojë korrigjimin, përveç nëse:

- korrigjimi nuk ka të bëjë me informatën në të cilën thirret personi i interesuar.
- korrigjimi nuk përmban të dhëna në lidhje me konstatimet e informatës,
- korrigjimi është në kundërshtim me interesat e mbrojtura me ligj të palëve të treta,
- kërkesa për publikim të korrigjimit nuk është e nënshkruar nga parashtuesi i kërkesës ose nga personi i autorizuar i trupit shtetëror ose personit juridik,
- korrigjimi është jo proporcionalisht më i madh nga informata për të cilën ka të bëjë, respektivisht pjesës së informatës në fjalë, përveç nëse korrigjimi ka të bëjë me shpifje ose informatë me përmbajtje ofenduese,
- korrigjimi është i shkruar në gjuhë që është identike me gjuhën në të cilën është publikuar informata e kontestuar,
- në rast kur bëhet fjalë për kritikë shkencore ose artistike, përveç nëse me të bëhet korrigjim i të dhënave të pasakta, ofenduese dhe tendencioze,

- veç më është kërkuar korrigjim për të njëjtën përmbajtje të informatës ose nëse vijon kontest para gjykatës kompetente për shkak të mos publikimit të korrigjimi,
- publikuesi i mediumit publikon vetë korrigjim të informatës së publikuar,
- kërkesa është parashtruar pas mbarimit të afatit të përcaktuar në nenin 15 paragrafi (2) të këtij ligji dhe
- korrigjimi përmban ofendim ose shpifje.

(4) Redaktori përgjegjës është i obliguar që në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, me shkrim ta njoftojë kërkuuesin e korrigjimit për arsyen e mospublikimit të korrigjimit, në afatin që është i përcaktuar për publikim të korrigjimit, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

Të drejtë të kopjes së publikimit

Neni 18

(1) Publikuesi i mediumit është i obliguar që personit të interesuar, të shpenzim të tij, ti sigurojë kopje nga informata e publikuar edhe atë më së voni në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga personi i interesuar.

(2) Kopja nga paragrafin (1) i këtij neni dorëzohet deri te personin i interesuar vetëm për përdorim personal.

(3) Nuk lejohet shumimi e as publikimi i kopjes nga paragrafi (1) i këtij neni pa pëlqimin e publikuesit të mediumit përveç në kuadër të procedurës gjyqësore.

(4) Në rast se publikuesi i mediumit nuk e ka ruajtur informatën e publikuar nga paragrafi (1) i këtij neni, do të konsiderohet se publikuesi i mediumit e ka publikuar informatën për të cilën kërkohet korrigjim.

Ruajtja e publikimit

Neni 19

Nëse personi i interesuar në afat prej tetë ditëve nga publikimi i informatës do të njoftojë me shkrim se kërkon publikim të korrigjimit, redaktori përgjegjës i mediumit, është i obliguar që ta ruaj publikimin e informatës në fjalë, kërkon nuk publikohet korrigjimi i kërkuar, respektivisht deri të përfundojë procedura gjyqësore që udhëhiqet në lidhje me informatat e publikuara që kontestohen, respektivisht deri sa nuk përfundojnë afatet e përcaktuara me ligj për realizimin e të drejtave për korrigjim ose mbrojtje gjyqësore.

Kërkesë për korrigjimin e publikuesit të mediumit që nuk ekziston

Neni 20

Publikimi i korrigjimit mund të kërkohet edhe kur informata publikohet nga publikuesi i mediumit i cili në ndërkohë ka pushuar së ekzistuari. Parashtruesi i kërkesës për korrigjim ka të drejtë që nga publikuesi i atij mediumi ose nga pasuesi i tij juridik, të kërkojë që në llogari të tij, ti sigurohet publikimi i korrigjimit në një medium tjetër, i cili sipas nivelit të shikueshmërisë/dëgjueshmërisë, respektivisht tirazhit është i ngjashëm me të.

E drejta e padisë

Neni 21

(1) Nëse redaktori përgjegjës i publikuesit të mediumit nuk e ka publikuar korrigjimin në mënyrë dhe afat të përcaktuar me nenin 17 të këtij ligji, personi i interesuar ka të drejtë që të iniciojë padi kundër redaktorit përgjegjës para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga skadimi i afatit për publikimin e korrigjimi, respektivisht nga dita kur korrigjimi nuk ka qenë i publikuar ose ka qenë i publikuar në mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.

(2) Kontestet gjyqësore në lidhje me publikimin e korrigjimit zgjidhen me procedurë urgjente.

(3) Redaktori përgjegjës është i obliguar që gjatë publikimit të korrigjimit pas përfundimit të procedurës gjyqësore të theksojë se publikimi realizohet në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor dhe në këtë drejtim është i obliguar që ta citojë aktgjykimin e shqiptuar.

Ndërrimi i redaktorit përgjegjës pas ngritjes së padisë

Neni 22

Nëse pas ngritjes së padisë për publikimin e korrigjimit, ndërrohet redaktori përgjegjës i publikuesit të mediumit, paditësi mund që deri në fund të seancës kryesore ta ndryshojë kërkesën e padisë dhe në vendin e të paditurit paraprak ta padisë redaktorin e ri përgjegjës. Për ndryshimin e kësaj të kërkesës për padi, nuk nevojitet pëlqim nga i padituri i parë, e as nga redaktori i ri përgjegjës.

E drejta e publikimit të informatave në lidhje me procedurat gjyqësore

Neni 23

(1) Çdo person fizik ose juridik, që përmendet në përmbajtjen e mediumit, se kundër tij është ngritur kallëzim penal ose procedurë hetimore ose penale, ka të drejtë që në afat prej tre muajve nga miratimi i vendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal, miratimit të aktvendimit të plotfuqishëm me të cilën ndërpritet procedura hetimore ose penale, ose miratimit të aktvendimit i plotfuqishëm lirues, të kërkojë që redaktori përgjegjës ta publikojë atë informatë.

(2) Gjatë publikimit të informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me procedurën për realizimin e të drejtës për korrigjim.

E drejta e korrigjimit të informatës së publikuar

Neni 24

(1) Personi fizik ose juridik ka të drejtë që të parashtrojë kërkesë deri te publikuesi i mediumit, respektivisht redaktori përgjegjës i publikuesit të mediumit, që pa kompensim, të publikojë përgjigje të tij për informatën e publikuar, nëse personi fizik ose juridik konsideron se ka lidhshmëri me faktet e theksuara e të publikuara në informatën ose nëse ka interes legjitim.

(2) Përgjigja nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban tekst ose porosi e të njëjtës natyrë dhe me të njëjtën gjatësi, sikurse informata e publikuar. Me përgjigjen

në mënyrë esenciale kundërshtohen ose plotësohen dukshëm konstatimet kontestuese për faktet dhe të dhënat në informatën e publikuar.

Mënyra e publikimit të përgjigjes

Neni 25

- (1) Përgjigja e informatës së publikuar duhet patjetër të publikohet pa ndryshim ose plotësim, me përjashtim të gabimeve drejtshkrimore.
- (2) Redaktori përgjegjës ka të drejtë që nga parashtuesi i kërkesës për publikimin e përgjigjes ndaj informatës së publikuar, para publikimit të kërkojë shkurtimin e përgjigjes.
- (3) Ndaj të drejtës së përgjigjes zbatohen dispozitat nga neni 17 të këtij ligji.
- (4) Redaktori përgjegjës mund të refuzojë publikimin e përgjigjes në rast kur informata e publikuar është pjesë e raportit të besueshëm nga seancat publike të organeve shtetërore dhe gjykatave.
- (5) Redaktori përgjegjës mund ta refuzojë publikimi e përgjigjes edhe në rast kur në përgjigje theksohen të dhëna ose deklarime dukshëm të pasakta, si dhe konstatime tjera që me siguri janë të pakëndshme për tu dëshmuar.
- (6) Nëse redaktori përgjegjës konsideron se vetëm disa prej të dhënave ose konstatimeve janë të pasakta ose të pakëndshme për dëshmim, ai nuk guxon që të refuzojë publikimin e përgjigjes pa thirrur paraprakisht parashtuesin e kërkesës për përgjigje, që të heq atë nga përgjigja e atyre të dhënave ose konstatimeve.

E drejta e padisë

Neni 26

Dispozitat nga neni 21 e këtij ligji që kanë të bëjnë me të drejtën për padi, në mënyrë adekuate zbatohen edhe në rast se redaktori përgjegjës i publikuesit të mediumit, nuk e publikon përgjigjen e informatës së publikuar.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 29

- (1) Gjobë në shumë prej 1.500 deri në 3.000 euro në kundërvlerë të denarit do ti shqiptohet për kundërvajtje, personit juridik nëse:
 - 2) nuk e kryen publikimin e korrigjimit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;
 - 3) nuk e kryen publikimin e korrigjimit në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me nenin 17 të këtij ligji;
 - 4) nëse personit të interesuar nuk i siguron kopje nga informata e publikuar, në pajtim me nenin 18 paragrafi (1) i këtij ligji;
 - 5) nuk e publikon informatën e kërkuar në pajtim me nenin 23 të këtij ligji dhe
 - 6) nuk e publikon përgjigje në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.
- (2) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë të denarit do ti shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, si dhe tregtarit individ për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.